



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE
DREJTORIA E FINANCËS, BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE

Nr. 299 Prot.,

Tiranë, më 18.07.2026

Lënda: Dërgohet raporti vjetor për vitin 2025 mbi monitorimin e buxhetit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)

MINISTRISË SË EKONOMISË DHE INOVACIONIT
DREJTORISË SË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR
Rruga “Dëshmorët e 4 Shkurtit”, Tiranë

Të nderuar,

Në zbatim të udhëzimit nr.14, datë 30.05.2023 “Për Procedurat Standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”, shtojca 3, po ju paraqesim informacionin narrativ mbi monitorimin e buxhetit për periudhën Janar – Dhjetor 2025, për AIDA-n.

• *Hyrje.*

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në mbështetje të ligjit nr. 10303, datë 15.07.2010 “Për krijimin dhe mënyrën e funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve”, ka për qëllim të rrisë konkurrueshmërinë e sektorit privat, forcimin e potencialit eksportues të vendit, promovimin dhe mbështetjen e investimeve të huaja direkte në Shqipëri, si dhe të promovojë potencialin turistik të vendit.

1. Informacioni buxhetor i agreguar

AIDA, në zbatim të ligjit nr. 115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025”, ligjit nr. 9936, datë 26.08.2008 “Për sistemin e menaxhimit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, udhëzimit nr.14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes

Rruga “Skerdilajd Llagami”, Nd.1, H.6, Tiranë
Tel: +355 (0)42251001, <http://www.aida.gov.al>, e-mail: info@aida.gov.al

Qendrore”, ligjit nr.10303, datë 15.07.2010 “*Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve*”(AIDA), gjatë periudhës raportuese Janar – Dhjetor 2025, ka administruar dhe menaxhuar fondet e vëna në dispozicion nga 2(dy) burime:

A. Buxheti i Shtetit në masën 264,221,000 lekë, ku përkatësisht në masën 227,221,000 lekë për shpenzime korrente lidhur me objektin e veprimtarisë së AIDA-s, konkretisht;

- Promovimi i Shqipërisë si destinacion investimesh dhe shërbimet e kujdesit ndaj klientit;

- Grante për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme,

dhe 37,000,000 lekë për shpenzime për investime me kapital të brendshëm.

Fondet buxhetore të akorduar për vitin 2025 gjatë periudhës raportuese janë miratuar dhe kanë pësuar këto ndryshime (shtesa / pakësime):

- Me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 16474/3 prot., datë 31.01.2025 “Dërgohet shkresa nr. 17786/17, datë 21.01.2025 “Detajimi i shpenzimeve korrente për vitet 2025-2027”, protokolluar këtu me nr. 218, datë 04.02.2025; miratimi i buxhetit fillestar për shpenzime korrente 227,221,000 lekë;
- Me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 2775/7 prot., datë 25.02.2025, protokolluar këtu me nr. 351/4, datë 25.02.2025, “Miratim transferim fondi shpenzime korrente, program 04130”, është shtuar fondi i llogarisë ekonomike 602 0000 në masën 13,000,000 lekë;
- Me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 3211/2 prot., datë 04.03.2025 “Dërgohet shkresa nr. 1110/1, datë 25.02.2025 “Detajimi i shpenzimeve kapitale për vitet 2025-2027”, protokolluar këtu me nr. 856, datë 06.03.2025; miratimi i buxhetit fillestar për shpenzime kapitale në masën 37,000,000 lekë;
- Me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) me nr.3211/5 prot., datë 28.03.2025, protokolluar këtu me nr. 987, datë 01.04.2025 është miratuar saktësimi i kapitullit për projektin “TVSH për projektet me financim të huaj”, nga kapitulli 01 në kapitullin 04.
- Me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) me nr. 2503/3 prot., datë 28.03.2025, protokolluar këtu me nr. 997, datë 03.04.2025, “Mbi miratimin e detajimit të planit për fondin e veçantë” është shtuar fondi i llogarisë ekonomike 606 0000 në masën 80,000 lekë.
- Me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit me nr. 2773/3 prot., datë 08.04.2025, miratuar ndryshimi i destinacionit të fondit të investimit duke e pakësuar fonde në masën 1,170,000 lekë në projektin ‘Përmirësime të sistemeve’, dhe shtuar projektin e ri “Blerje pajisje zyre AIDA”, në masën 1,170,000 lekë.
- Me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 5463/4 prot., datë 03.06.2025 “Dërgohet shkresa nr.7329/1, datë 20.05.2025 “Transferim fondi për shpenzime kapitale””, është miratuar shtesa e fondeve në llogarinë ekonomike 231, “Fond i Konkurrshmërisë” në masën 873,333 lekë dhe pakësimi i fondeve në llogarinë ekonomike 231, “Mbështetje e Bisnesit Kreativ”, në masën 873,333 lekë.

- Me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr.7582 prot., datë 05.06.2025, protokolluar këtu me nr. 1188/2, datë 10.06.2025, “Miratim transferim fondi shpenzime korrente, program 04130”, është shtuar fondi në llogarinë ekonomike 602 0000 në masën 10,000,000 lekë;
- Me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit nr.814/8 prot., datë 11.12.2025, protokolluar këtu me nr. 2124, datë 15.12.2025, “Dërgohet shkresa nr.14505/135 “Miratim pjesor i ndryshimit të buxhetit për vitin 2025”, në zbatim të Aktit Normativ nr.10, datë 08.10.2025 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.115/2024, “Për buxhetin e vitit 2025”, janë shtuar fondet buxhetore në kodin e ministrisë së linjës 04, në grupin e shpenzimeve korrente artikulli 600 në masën 18,379,012 lekë dhe artikulli 601 në masën 1,111,519 lekë, duke pakësuar fondet në kodin e ministrisë së linjës 12, në të njëjtin artikull dhe në të njëjtën masë (bazuar në vendimin nr. 516, datë 25.9.2025, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit”, u ndryshua kodit i ministrisë së linjës për AIDA, ishte 12 dhe bëhet 04);
- Me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit nr.814/9 prot., datë 17.12.2025, protokolluar me tonën nr. 2157, datë 22.12.2025, “Dërgohet shkresa nr.14505/166 datë 04.12.2025, “Në zbatim të Aktit Normativ nr.10, datë 08.10.2025”, janë në kodin e ministrisë së linjës 04, në grupin e shpenzimeve kapitale artikulli 231 në masën 8,526,757 lekë, duke pakësuar fondet në kodin e ministrisë së linjës 12, në artikullin 231 dhe në të njëjtën masë (bazuar në vendimin nr. 516, datë 25.9.2025, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit”, u ndryshua kodit i ministrisë së linjës për AIDA, ishte 12 dhe bëhet 04);
- Me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit nr.2839/4 prot., datë 09.01.2026, protokolluar me tonën nr. 76, datë 20.01.2026, “Dërgohet shkresa nr.18059/76, datë 19.12.2025, “Në zbatim të Aktit Normativ nr.11, datë 19.12.2025”, janë pakësuar fonde në grupin e shpenzimeve kapitale artikulli 231 “TVSH për projekte me financim të huaj” në masën 1,300,000 lekë; e cila lidhet me fondin që përdoret për financimet e huaja ku TVSH rimbursohet nga shteti në rast se gjatë zbatimit të aktiviteve gjenerohen shpenzime me këtë përmbajtje;
- Me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit nr.2839/6 prot., datë 20.01.2026, protokolluar me tonën nr. 137, datë 22.01.2026, “Dërgohet shkresa nr.18550, datë 31.12.2025, “Në zbatim të Aktit Normativ nr.11, datë 19.12.2025, për shpenzime korrente”, janë pakësuar fonde në grupin e shpenzimeve korrente artikulli 600, në masën 13.317,573 lekë; dhe fonde në grupin e shpenzimeve korrente artikulli 601, në masën 281,597 lekë;

B. Financim i huaj me shkresën e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) nr. 3771/3 prot., datë 28.03.2025, protokolluar këtu me nr. 991, datë 02.04.2025 “Detajim pjesor i buxhetit për shpenzime kapitale”, është detajuar buxheti i planifikuar për vitin 2025 për shpenzime për investime me kapital të jashtëm nga financimet e huaja për 2 (dy) projektet në ndjekje nga AIDA, në masën totale prej 5,300,000 lekë, konkretisht projekti Skills for Jobs Albania Montenegro dhe projekti EEN ALBANIA.

Gjatë vitit ushtrimor 2025 nga donatori janë transferuar fonde në total në masën 7,277,840.26 lekë. Kjo shumë përbëhet nga:

- 4,952,420.46 lekë si transhi i I-rë dhe i II-të, në zbatim të marrëveshjes me numër 101075194 — EEN-ALBANIA lidhur midis institucionit tonë dhe European Innovation Council and SMEs Executive Agency (EISMEA)
- 2,325,419.8 lekë si transhi i I-rë, në zbatim të marrëveshjes me numër 101236267 — EEN-ALBANIA lidhur midis institucionit tonë dhe European Innovation Council and SMEs Executive Agency (EISMEA).

Ndërkohë për mbajtjen e aktiviteteve referuar projekteve janë shpenzuar 4,499,586.08 lekë.

Në përfundim të vitit 2025, rezulton se fondi i rishikuar për AIDA-n është në total në masën 275,701,830 lekë (nga të cilat: 270,401,830 lekë financim nga Buxheti Shtetit dhe 5,300,000 lekë Financim i Huaj).

◦ Performanca e AIDA-s gjatë periudhës raportuese Janar – Dhjetor 2025

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2025, AIDA ka shënuar rritje në nivel performance, si në aktivitetet përfaqësuese me palë të treta, ashtu edhe në përkrahjen e investitorëve vendas dhe të huaj.

a) Performanca e produktit: *“Promovimi i Shqipërisë si destinacion investimesh dhe shërbimet e kujdesit ndaj klientit”.*

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2025, AIDA ka realizuar aktivitete në kuadër të zbatimit të objektivave dhe funksioneve të veta, si më poshtë:

1. Pjesëmarrje në panairë ndërkombëtare.

- Në kuadër të promovimit të kompanive shqiptare në tregjet e huaja dhe me synim nxitjen e eksportit, AIDA ka marrë pjesë me stende në disa panairë ndërkombëtare:

- “Biofach 2025”, në datat 11-14 Shkurt 2025, Nuremberg, Gjermani
Në këtë panair morrën pjesë 8 kompani, 6 kompani nga sektori i bimëve medicinale dhe aromatike dhe 2 kompani nga sektori i vajit të ullirit. Kompanitë realizuan 467 kontakte me kompani të huaja.
- “Wine Paris”, në datat 10-12 Shkurt 2025, Paris, Francë
Në këtë panair morrën pjesë 3 kompani të sektorit të verës. Kompanitë realizuan 20 kontakte me kompani të huaja.
- “Food Expo”, në datat 08-10 Mars 2025, në Athinë, Greqi.

Në këtë panair morrën pjesë 6 kompani, 2 kompani nga sektori i bimëve medicinale dhe aromatike, 3 kompani nga sektori i verës dhe një kompani e kafes. Kompanitë realizuan 209 kontakte me kompani të huaja.

- **“Riga Food”, në datat 04-06 Shtator, në Letoni.**

Në këtë panair morën pjesë 6 kompani: 1 kompani nga sektori i bimëve medicinale dhe aromatike, 1 kompani nga sektori i mjaltit, 1 kompani nga sektori i ullinjve dhe i vajit të ullirit, 1 kompani nga sektori i frutave të freskëta (luleshtrydhe), 1 kompani nga sektori i përpunimit të domateve dhe 1 kompani nga sektori i përbërësve ushqimor. Kompanitë realizuan 199 kontakte me kompani të huaja.

- **“A+A” Dyseldorf Gjermani, në datat 04-07 Nëntor 2025, panair i sigurisë në punë dhe uniformave.**

Në këtë panair morën pjesë 5 kompani të sektorit të veshjeve të punës/uniformave. Kompanitë pjesëmarrëse në panair realizuan: 280 takime B2B me kompani ndërkombëtare; hyn në bisedime për 50 kontrata të mundshme; tërhoqën interesimin e shteteve të tilla si; Gjermania, Italia, Spanja, Belgjika, Kroacia, Hollanda, Norvegjia, Çekia, Austria, Franca, Polonia, Greqia, Tunizia, Turqia, etj. Pjesëmarrja në Panairin Ndërkombëtar A+A 2025 hapi mundësi reale për rritjen e eksporteve dhe përfshirjen e prodhuesve shqiptarë në zinxhirët e furnizimit ndërkombëtar.

- **“Organic Expo Dubai”, në datat 17-19 Nëntor 2025, Emiratet e Bashkuara Arabe.**

Në këtë panair morën pjesë 5 kompani: 1 kompani nga sektori i bimëve medicinale dhe aromatike, 1 kompani nga sektori i ullinjve dhe i vajit të ullirit, 1 kompani nga sektori i lëngjeve të frutave dhe ujit, 2 kompani nga sektori i vajrave esencialë. U realizuan rreth 205 kontakte biznesi, prej të cilave rreth 22 marrëveshje paraprake me kompani ndërkombëtare, një tregues i qartë i potencialit dhe konkurrueshmërisë së produkteve tona natyrore.

-Në kuadër të nxitjes së investimeve të huaja, zhvillimin e potencialeve turistike në vend dhe promovimin e Shqipërisë, AIDA ka marrë pjesë në disa panaiere ndërkombëtare:

- **“ITB Berlin”, në datat 04-06 Mars 2025, Berlin, Gjermani.**

Më këtë panair, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, mori pjesë si bashkë-ekspozuese krahas Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

ITB Berlin (Internationale Tourismus-Börse Berlin) është panairi më i madh i turizmit në botë, i cili tërheq shumë ekspozues dhe pjesëmarrës dhe mbetet një platformë kyç për rrjetëzimin, inovacionin dhe turizmin global. Gjithashtu luan një rol jetik në formësimin e trendeve, politikave dhe partneriteteve në sektorin e turizmit. Kompanitë e përfaqësuara në panair përfshijnë hotele, struktura akomoduese, operatorë turistikë, linja ajrore etj.

Kompanitë e përfaqësuar në panair përfshijnë hotele, struktura akomoduese, operatorë turistikë, linja ajrore dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm të industrisë së turizmit.

Në këtë panair, Shqipëria kishte Vendin e Nderit si **Host Country**, ndërsa AIDA mori pjesë në rolin e institucionit përgjegjës për tërheqjen e investimeve të huaja direkte në sektorin e turizmit, si një nga sektorët prioritarë dhe strategjikë për zhvillimin e vendit.

Pjesëmarrja synonte gjithashtu prezantimin e paketave më të reja të incentivave në sektor, koordinimin e takimeve me kompani të interesuara për partneritet, si dhe mbështetjen e kompanive shqiptare në zhvillimin e takimeve të planifikuara gjatë panairit.

- **“Panairi i Punës”, “Puno & Jeto Aty Ku Ke Zembrën”, në datën 2 Mars 2025, Athinë, Greqi.**

AIDA mori pjesë në këtë panair, me qëllim informimin dhe prezantimin e mundësive të reja për punësim, investim dhe rikthim në Shqipëri të shqiptarëve që jetojnë dhe punojnë në Greqi, me synimin për të kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.

Pjesëmarrja e AIDA-s u fokusua në tërheqjen e investimeve nga diaspora, si dhe në informimin mbi mundësitë konkrete për zhvillimin e biznesit në Shqipëri.

Në panair morën pjesë kompani të ndryshme shqiptare që operojnë në sektorë si bujqësia, ndërtimi, turizmi, teknologjia, etj. Krahas subjekteve private, të pranishme ishin edhe institucione shtetërore, përfshirë: Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), Ministrinë e Energjisë dhe Infrastrukturës (MIE), Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM), Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ), Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), Albanian Investment Corporation (AIC), si dhe Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA).

- **“Panairi i MIPIM”, në datat 11-14 Mars 2025, Kanë, Francë.**

Duke qenë se MIPIM (Marché International des Professionnels de l'Immobilier) është event i madh dhe më prestigjioz global në industrinë e pasurive të paluajtshme, i cili mbledh çdo vit investitorë, zhvillues, institucione financiare dhe aktorë të tjerë kryesorë të sektorit, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), mori pjesë me synim tërheqjen e investimeve të huaja direkte dhe promovimin e Shqipërisë si destinacion konkurrues për investime.

Gjatë pjesëmarrjes në panair, u zhvilluan një sërë takimesh me investitorë dhe operatorë ndërkombëtarë, duke prezantuar potencialet e Shqipërisë, avantazhet konkurruese dhe mundësitë konkrete për investim në sektorin e pasurive të paluajtshme dhe zhvillimit urban.

Në kuadër të aktivitetit, AIDA nënshkroi gjithashtu një marrëveshje bashkëpunimi me Miami Association of Realtors, shoqata më e madhe e profesionistëve të pasurive të paluajtshme në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me synim forcimin e bashkëpunimit dhe promovimin e mëtejshëm të mundësive të investimit në Shqipëri.

- **Panairi ndërkombëtar VivaTech 2025, në datat 11-14 Qershor, Paris, Francë.**

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), mori pjesë për herë të parë në panairin ndërkombëtar të teknologjisë dhe inovacionit VivaTech 2025, i zhvilluar në Paris më 11-14 Qershor 2025. Në stendën e përbashkët të Shqipërisë, nën moton “Albania Future Now”, u promovuan mundësitë e vendit në sektorin ICT/BPO dhe ekosistemin e inovacionit, duke u realizuar dhjetëra takime me kompani ndërkombëtare të profilit të lartë si IBM, Amazon, Eviden, inetum, etj. Fushata outreach e ndërmarrë nga AIDA gjatë këtij eventit rezultoi e suksesshme, duke gjeneruar interes konkret nga investitorë potencialë dhe partnerë ndërkombëtarë, si dhe duke hapur rrugën për bashkëpunime të reja strategjike në fushën e teknologjisë dhe shërbimeve të biznesit.

- **Forumi expo 40/40 të organizuar nga Bloconomy**

AIDA mori pjesë në Expo 40/40, të organizuar nga BLOCONOMY, duke qenë pjesë e një paneli para anëtarëve pjesëmarrës. Në këtë aktivitet u prezantuan mundësitë që AIDA ofron për bizneset shqiptare dhe rajonale, duke përfshirë takime B2B, pjesëmarrjen në panire kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe mundësitë për mbështetje financiare në zhvillim dhe zgjerim. Forumi shërbeu si një hapësirë e rëndësishme për sipërmarrësit në krijimin e partneriteteve dhe zgjerimin e bashkëpunimeve të reja.

2. Strategjia e Eksporteve

Platforma e Eksporteve

Për të mbështetur ndërkombëtarizimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, si dhe për të përforcuar misionin e AIDA-s në ofrimin e shërbimeve me vlerë të shtuar të lidhura ngushtë me eksportin dhe zgjerimin e aktivitetit tregtar të sipërmarrjeve shqiptare në tregjet ndërkombëtare, AIDA ka lançuar Platformën e Eksporteve. Platforma është promovuar në të gjitha rrjetet sociale të AIDA-s dhe është e aksesueshme në adresën www.exportalbania.al.

Përmes kësaj platforme, kompanitë kanë mundësinë të regjistrohen dhe të krijojnë profile të detajuara, duke promovuar produktet dhe shërbimet e tyre për një audiencë globale. Bizneset e regjistruara përfitojnë gjithashtu akses ekskluziv në platformën “Compass”, një mjet i vlefshëm që u mundëson identifikimin dhe eksplorimin e tregjeve të reja, lidhjen me partnerë potencialë, distributorë dhe blerës, si dhe shfrytëzimin e mundësive të reja të biznesit në tregjet ndërkombëtare.

Duke thjeshtuar procesin e aksesit në mbështetjen për eksport, platforma është konceptuar si një zgjidhje strategjike për fuqizimin e kompanive shqiptare, zgjerimin e pranisë së tyre në tregje, rritjen e konkurrueshmërisë dhe arritjen e suksesit në tregun global.

AIDA organizoi gjatë muajit qershor, “Info Day” dhe “Takime door to door” me bizneset eksportuese të qarqeve, Shkodër, Gjirokastrë, Elbasan, Durrës, Berat (faza e parë), ku është bërë promovimi i platformës dhe sensibilizimi i kompanive eksportuese shqiptare për të përfituar nga shërbimet që ofron kjo platformë. Gjithsej në platformën B2B, janë regjistruar 155 kompani eksportuese të sektorëve të ndryshëm. Gjatë vitit 2026 do vijojë faza e dytë me informimin dhe regjistrimin e bizneseve.

Plan veprimi e-commerce

Në kuadër të kësaj iniciative, tek fondi i zhvillimit të NMVM-ve, një nga zërat për zhvillimin e biznesit elektronik është: *Krijimi i aplikacioneve apo platformave në funksion të zhvillimit të proceseve lidhur me tregtinë elektronike/e-commerce, produkteve të reja dhe/ose shërbimeve, për të përmbushur kërkesat e industrisë së tregut në vend dhe rajon për të përmirësuar biznesin, sistemet logjistike etj;*

Gjatë vitit 2025, janë mbështetur gjithsej 30 biznese përkatësisht:

- Platforma dhe promovim (12)
- Digjitalizim dhe ëbsite (12)
- Aplikacione, e-commerce, marketing dhe përmirësim produkti (8)

Program për aftësitë sipërmarrëse për NVM , Trajnim

- Trajnim i organizuar nga AIDA në bashkëpunim me Damiani&Partners dhe GIZ Albania në datën 3 Korrik 2025.

Tema e trajnimit: “Gatishmëria për Eksport”

Me kompanitë e sektorëve agropërpunim, pije dhe ushqim, druri dhe produkte prej druri.

Gjithsej 60 biznese pjesëmarrëse në trajnimet e kryera gjatë vitit 2025.

3. Evente

- “Match Make· Albania 2025” me fokus nxitjen e investimeve

Në muajin Mars 2025, për herë të parë, AIDA organizoi eventin Match Maker Albania, një nga ngjarjet më të rëndësishme për nxitjen e investimeve dhe bashkëpunimit ekonomik në Shqipëri. Kjo platformë unike synon të lidhë investitorë të huaj me mundësi konkrete në tregun shqiptar, duke ofruar hapësira për takime direkte B2B (biznes me biznes) dhe B2G (biznes me qeveri).

Fakte kryesore të eventit:

- Të pranishëm përfaqësues nga 37 shtete, duke reflektuar interesin e gjerë ndërkombëtar.
- Mbi 500 investitorë të huaj morën pjesë për të eksploruar mundësitë që ofron Shqipëria.
- Eventu mbledhi më shumë se 1000 pjesëmarrës, përfshirë sipërmarrës, diplomatë, përfaqësues institucionesh dhe media.

- U prezantuan 30 kompani eksportuese shqiptare, të cilat ofruan partneritete të mundshme për tregjet ndërkombëtare.
- 30 projekte konkrete investimi, kryesisht në sektorin e turizmit dhe real estate.
- 10 institucione publike dhe mbështetëse ishin të pranishme me info desk për të ofruar informacion dhe asistencë për investitorët.

- “Zan’Art” me fokus nxitjen e bizneseve kreative

Eventi “Zan’Art”, u mbajt në datën 30 Prill 2025, në Tiranë.

Qëllimi kryesor i eventit “Zan’Art” ishte të promovojë trashëgiminë kulturore përmes artizanatit dhe të krijojë mundësi konkrete për rritjen e vizibilitetit dhe shitjeve të produkteve artizanale. Ky event kishte për qëllim jo vetëm promovimin por ndërveprimin me target grupe të interesuara për produktet e tyre duke menduar zgjerimin e tregjeve. Nga ana tjetër, në këtë event u organizuan tavolina diskutimit/panelet me aktoreve të sektorit dhe institucioneve shtetërore për të adresuar sfidat e artizanatit në Shqipëri dhe planet strategjike. Një mundësi kjo unike promovimi, ndërveprimi dhe diskutimi.

Ky event lindi si një nevojë për të ofruar një hapësirë të dedikuar, ku artizanët tanë mundën të prezantojnë produktet e tyre autentike, ku arritën të ndërveprojnë me publikun dhe aktorë të tjerë të tregut, si dhe mundësinë për krijimin e partneritete të reja për zhvillimin e mëtejshëm të aktiviteteve të tyre. Zan’Art krijojë një urë të gjallë ndërmjet brezave, duke i rikthyer artizanatit shqiptar vendin që meriton në shoqëri – jo thjesht si mjeshtëri, por si një formë e gjallë e trashëgimisë kulturore. Ky event shërbeu si një pedestal për duar-artët, ata që me pasion dhe durim ruajnë dhe përcjellin vlerat tona kombëtare. Çdo qepje, gdhendje, thurje apo ngjyrosje mbart një histori – një frymë të hershme që flet për identitetin tonë, për rrënjët dhe shpirtin e këtij vendi. Zan’Art ishte një thirrje për ta vlerësuar të bukurën e krijuar me dorë, për të dëgjuar zërin e heshtur të zanateve dhe për të rindërtuar lidhjen emocionale me atë që është autentike, e thellë dhe e trashëguar.

Eventi Zan’Art krijoi një hapësirë të dedikuar për promovimin dhe fuqizimin e artizanëve shqiptarë, duke i vendosur ata në qendër të vëmendjes si bartës të trashëgimisë sonë kulturore. Përmes këtij aktiviteti arritëm të risitim ndërgjegjësimin publik mbi vlerat e artizanatit tradicional, nxitjen e blerjeve direkte dhe krijimin e mundësive të reja ekonomike për artizanët pjesëmarrës. Gjithashtu, Zan’Art kshihte si synim ruajtjen dhe transmetimin e mjeshtëritë tradicionale tek brezat e rinj, duke i kthyer këto profesione në mundësi të qëndrueshme punësimi, përmes workshopeve dhe demonstrimeve të shfaqura gjatë gjithë eventit.

Në këtë event ishte i pranishëm Ministri i Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit z. Blendi Gonxhe, përfaqësues nga Ministria e Turizmit, Ministria e Bujqësisë, Kryetarja e Unioinit të Dhomave të Tregëtisë, përfaqësues nga Dhoma Kombëtare e Zejtarisë, përfaqësues nga Bashkitë e qyteteve me trashëgimi kulturore, përfaqësues të institucioneve kulturore si, Muze, Akademi Artesh. Aktiviteti u organizua në formën e një panairi të mirëfilltë, ku ekspozuan produktet e tyre

Rruga “Skerdilajd Llagami”, Nd.1, H.6, Tiranë

Tel: +355 (0)42251001, <http://www.aida.gov.al>, e-mail: info@aida.gov.al

rreth 35 biznese artizane, të sektorëve të kostumeve popullore, drurit, qeramikës, pocerisë, xhamit, pikturës, maskave artizanale, qendisjes, ushqimores, bizhuterisë etj.

Ky aktivitet pati fokus ndërgjegjësimin e bizneseve që kanë në fokus artizanët, dyqane që tregtojnë produktet e artizanatit, struktura elitare akomoduese, partnerët dhe mbështetësit e këtij sektori, përfaqësuesit e tregjeve ndërkombëtare, përfshirë shpërndarësit, retailer-at, dhe organizatat ndërkombëtare, institucionet mbështetëse, si dhomat e tregtisë, ambasadat, dhe organizatat zhvillimore.

4. Përkujdesja ndaj investitorëve (Takime aftercare)

Gjatë vitit 2025, Sektori Lead & Aftercare pranë Drejtorisë së Investimeve të Huaja, Partneritetit dhe Kërkimit në AIDA organizoi 1 fushatë të shërbimit të përkujdesjes ndaj investitorit, dhe 1 tryezë të rrumbullakët me kompani të sektorit të ICT-BPO dhe teknologjisë së informacionit dhe ndërmori nismën "Investor Support Days". Rrjeti i bashkëpunimit me qeverisjen lokale funksionon aktualisht me 12 bashki të vendit, përkatësisht Shkodër, Vlorë, Tiranë, Durrës, Berat, Lezhë, Fier, Elbasan, Kavajë, Vorë, Kamëz dhe Bashkinë Korçë.

Në kuadër të zhvillimit të forumit më të madh të investimeve Match-Maker Albania, i cili u mbajt për herë të parë në muajin mars, u realizuan 29 takime me subjekte të huaj dhe vendas, duke i asistuar gjatë eventit me ndërlidhje kontaktesh dhe bashkëpunimesh me palët relevante, kompani, institucione shtetërore, ambasada, agjenci homologe investimesh etj.

Në muajt Prill-Maj u zhvillua fushata Aftercare me kompani të sektorit ICT-BPO, në bashkëpunim me Shoqatën ABSL Albania, gjatë së cilës u realizuan takime me 11 kompani. Në këtë kuadër u organizua gjithashtu Tryeza e Rrumbullakët e Sektorit ICT-BPO, me pjesëmarrjen e 18 kompanive nga sektori.

Me bashkëpunimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit AIDA finalizoi me sukses nismën "Investor Support Days". Kjo iniciativë u zhvillua përmes takimeve javore me kompanitë zvicerane, britanike dhe amerikane. AIDA pati përfaqësinë e institucioneve si Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, etj. Gjithashtu ambasadat e Zvicrës, Mbretërisë së Bashkuar si dhe SWISSA-s, Dhomës Britanike të Tregtisë dhe AmCham.

Në këto tryeza morën pjesë një total prej 54 kompanish. Në vijim të problematikave të raportuara janë dërguar dhe po ndiqen me prioritet shkresat dhe korrespondenca elektronike me institucionet e qeverisjes qendrore për kompanitë.

Në total, përgjatë vitit 2025, AIDA ka takuar 112 kompani përmes vizitave në terren, tryezave të rrumbullakëta, si edhe përmes iniciativave të tjera të ndërmarra në kuadër të angazhimit të saj me kompanitë e huaja dhe vendase.

5. Nxitja dhe tërheqja e Investimeve të Huaja Direkte (Forume biznesi dhe Fusha outreach)

Përgjatë periudhës Janar – Dhjetor 2025, Drejtoria e Investimeve të Huaja Direkte, Partneritetit dhe Kërkimit ka organizuar Forumin e Biznesit Shqipëri – Francë dhe Forumin e Biznesit Shqipëri – Egjipt.

- Forumi i Biznesit Shqipëri – Egjipt u organizua në muajin Shkurt 2025 dhe qëllimi ishte identifikimi dhe krijimi i mundësive për bashkëpunim ekonomik të ndërsjelltë me kompanitë shqiptare në sektorë si pasuria e paluajtshme, energjia e rinovueshme dhe prodhimi e distribucioni i pajisjeve laboratorike, mjekësore e më gjerë.
- Në muajin Mars 2025, AIDA, në bashkëpunim me Ambasadën Franceze në Shqipëri, organizoi Forumin e Biznesit Shqipëri-Francë, me pjesëmarrjen e një delegacioni të rëndësishëm nga MEDEF International.

Gjatë forumit u prezantuan potencialet e bashkëpunimit ekonomik mes dy vendeve dhe roli i Shqipërisë si një destinacion atraktiv për investime, në sektorë si pasuria e paluajtshme, aktivitetet financiare, ndërtimi etj.

◦ Forumi ekonomik WB6 – EU

Më datë 13-14 Tetor 2025, në Pallatin e Kongreseve në Tiranë, u zhvillua Forumi i Investimeve EU-WB6, një ngjarje dyditore me rëndësi strategjike e fokusuar në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet agjencive të promovimit të investimeve të Ballkanit Perëndimor dhe në nxitjen e investimeve të huaja direkte në rajon.

Forumit mblodhi përfaqësues të nivelit të lartë nga vendet e rajonit, Bashkimi Evropian dhe institucione kyçe ndërkombëtare, përfshirë edhe Presidentin e Komisionit Evropian, znj. Ursula von der Leyen, duke shërbyer si një platformë për dialog, koordinim dhe shkëmbim praktikash më të mira.

Në kuadër të forumit, Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s, znj. Laura Saro, firmosi disa Deklarata të Përbashkëta Bashkëpunimi, me synimin për të forcuar marrëdhëniet ekonomike ndërrajonale dhe për të promovuar Ballkanin Perëndimor si një destinacion të unifikuar dhe konkurrues për investime.

◦ Side event “IPAs connect”

Në kuadër të Forumit Ekonomik WB6-BE, AIDA organizoi aktivitetin paralel “IPAs Connect”, i cili bashkoi përfaqësues nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, Bashkimi Evropian, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC), si dhe Banka Botërore.

Në këtë aktivitet morën pjesë agjencitë e investimeve të Shqipërisë (AIDA), Bosnjë dhe Hercegovinës, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë, duke krijuar një platformë të strukturuar dialogu dhe bashkëpunimi ndër-institucional.

Aktiviteti mbledhi së bashku aktorë kyç nga Ballkani Perëndimor dhe Bashkimi Evropian, duke shërbyer si një hapësirë për shkëmbimin e përvojave, praktikave më të mira dhe mundësive të investimit në rajon. Pjesëmarrja e përfaqësuesve kontribuoi në pasurimin e diskutimeve, në ndarjen e informacionit mbi tregjet kombëtare përkatëse, si dhe në forcimin e bashkëpunimit rajonal në fushën e promovimit dhe lehtësimit të investimeve.

Gjithashtu, përfaqësues nga Gjermania, Franca, Italia, Hungaria, si dhe vende të tjera evropiane, prezantuan praktika të suksesshme në promovimin e investimeve, duke theksuar potencialin e Ballkanit Perëndimor si një destinacion konkurrues dhe në rritje për investimet e huaja direkte.

◦ **Forumi ekonomik Shqipëri – Turqi**

Më datë 17 Tetor u zhvillua Forumi më i Madh i Investimeve Shqipëri – Turqi 2025, një ngjarje e rëndësishme e organizuar nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) në bashkëpunim me MÜSİAD Albania.

Forumi shërbeu si një platformë e nivelit të lartë për të forcuar bashkëpunimin ekonomik, për të rritur shkëmbimet tregtare dhe për të identifikuar mundësi të reja investimi midis dy vendeve. Forumi mbledhi përfaqësues të qeverive, investitorë, sipërmarrës, organizata biznesi dhe stakeholderë të rëndësishëm nga Shqipëria dhe Turqia.

Në kuadër të Forumit u zhvilluan edhe katër panele tematike, të cilat adresuan sektorët kryesorë strategjikë të zhvillimit ekonomik dhe investimeve, me tematika:

- Paneli I: “Turizmi i së Nesërme: Investime për një Destinacion Elitar”,
- Paneli II: “Zhvillimi Strategjik i Infrastrukturës dhe Ndërtimit”,
- Paneli III: “Bujqësia në Fokus: Rritja e Investimeve dhe Zhvillimi i Sektorit”, si dhe
- Paneli IV: “E Ardhmja Digjitale e Shqipërisë: Inovacioni dhe Potenciali i Investimeve”.

Panelistët ofruan diskutime të thelluara mbi mundësitë konkrete të bashkëpunimit dhe investimeve mes Shqipërisë dhe Turqisë.

Forumi i Investimeve Shqipëri–Turqi 2025 shënon hapjen e një kapitulli të ri në partneritetin strategjik midis dy vendeve dhe krijon bazat për një zhvillim të qëndrueshëm, rritje të investimeve dhe forcim të marrëdhënieve tregtare në vitet që vijnë.

◦ **Tirana Economic Forum**

Më 10 Dhjetor, në kuadër të Tirana Economic Forum, liderë politikë, përfaqësues të biznesit dhe akademikë u mbledhën për të diskutuar sfidat dhe perspektivat e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë

dhe rajonit. Forumi shërbeu si një platformë e rëndësishme dialogu mbi politikat ekonomike, klimën e investimeve dhe bashkëpunimin rajonal.

Një nga sesionet kryesore të forumit ishte paneli “Albania’s Investment Pulse: How Can Albania Attract Quality Investment”, i cili u fokusua në strategjitë për tërheqjen e investimeve cilësore dhe drejtimet strategjike të zhvillimit ekonomik të vendit.

Në këtë panel morën pjesë përfaqësues nga sektori publik, biznesi dhe institucionet financiare ndërkombëtare. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) ishte e përfaqësuar në këtë panel, duke kontribuar në diskutimet mbi përmirësimin e klimës së investimeve, rolin e reformave, infrastrukturës dhe partneriteteve në rritjen e konkurrueshmërisë së Shqipërisë si destinacion investimesh.

◦ **Forum i Biznesit Shqipëri–Japoni**

Më 21 Nëntor 2025, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në bashkëpunim me Japan External Trade Organization (JETRO), organizoi për herë të parë në Tiranë Forumin e Biznesit Shqipëri–Japoni, si pjesë e misionit të biznesit japonez në Shqipëri. Aktiviteti mbledhi kompani të njohura japoneze si Sumitomo Heavy Industries, Fujitsu Ltd., FujiClean Co., Ltd., Hagihara Industries Inc. dhe PADECO Co., Ltd., si dhe përfaqësues të Japan Bank for International Cooperation (JBIC), duke adresuar mundësi konkrete bashkëpunimi në sektorët e energjisë, infrastrukturës, teknologjisë dhe mjedisit. Në vijim të forumit, u zhvillua një vizitë në Piramida e Tiranës dhe një takim me Startup Albania, ku startup-et shqiptare prezantuan projektet e tyre inovative, duke forcuar urat e bashkëpunimit dhe perspektivën për investime të përbashkëta Shqipëri–Japoni.

◦ **Forum i Ekonomik Shqipëri – Egjipt**

Në datat 12-14 Dhjetor 2025, në Tiranë u zhvillua Forumi i Biznesit Shqipëri–Egjipt, i cili mbledhi përfaqësues të nivelit të lartë nga institucionet publike dhe komuniteti i biznesit të të dy vendeve, me qëllim forcimin e bashkëpunimit ekonomik dhe nxitjen e partneriteteve strategjike. Forumi u zhvillua me pjesëmarrjen e ministres së Ekonomisë dhe Inovacionit të Shqipërisë, znj. Delina Ibrahimaj, dhe ministres së Planifikimit, Zhvillimit Ekonomik dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Republikës Arabe të Egjiptit, Dr. Rania Al-Mashat.

Diskutimet u fokusuan në rritjen e shkëmbimeve tregtare, nxitjen e investimeve të ndërsjella dhe zhvillimin e projekteve të përbashkëta në sektorë strategjikë si energjia, turizmi, bujqësia, teknologjia dhe punësimi. Një nga rezultatet më të rëndësishme të forumit ishte nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit midis Autoritetit të Përgjithshëm për Investime dhe Zonat e Lira të Republikës Arabe të Egjiptit (GAFI) dhe Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), i cili synon thellimin e bashkëpunimit në fushën e investimeve dhe përmirësimin e klimës së biznesit.

Forumi shërbeu si një platformë kyçe për forcimin e dialogut institucional dhe ekonomik mes Shqipërisë dhe Egjiptit, duke krijuar baza të qëndrueshme për bashkëpunim afatgjatë dhe iniciativa konkrete zhvillimi.

- **Fusha outreach**

Gjatë vitit 2025, AIDA organizoi dy fushata outreach për tërheqjen e investimeve të huaja, të fokusuara në sektorët ICT/BPO dhe manifakturën e pajisjeve mjekësore.

- Në kuadër të fushatës outreach në sektorin ICT/BPO, AIDA, në bashkëpunim me ABSL Albania, zhvilloi një takim me përfaqësuesin e kompanisë Secitops, me qëllim eksplorimin e interesit për investim në Shqipëri në fushën e fintech, financës digjitale dhe shërbimeve të biznesit.

Gjatë diskutimeve, kompania prezantoi interesin për krijimin e një platforme digjitale dhe hapjen e një banke online, të fokusuar në transfertat ndërkombëtare të parave dhe ofrimin e shërbimeve financiare për sektorin ICT dhe outsourcing, duke e konsideruar Shqipërinë si një treg potencial për zgjerim të operacioneve të saj.

Gjatë takimit, AIDA prezantoi potencialin e Shqipërisë si destinacion konkurrues për investime në ICT/BPO, duke vënë në pah fuqinë punëtore të kualifikuar, kostot konkurruese, si dhe pozicionin strategjik të vendit në raport me tregjet e Bashkimit Evropian. Në vijim, AIDA do të mbajë komunikim të vazhdueshëm me kompaninë dhe do të koordinohet me institucionet përkatëse financiare dhe rregullatore për të vlerësuar më tej realizueshmërinë dhe hapat konkretë për zhvillimin e këtij projekti në Shqipëri.

- Fushata e dytë, me fokus manifakturën e pajisjeve mjekësore, u organizua me mbështetjen e Regional Cooperation Council (RCC) dhe u zhvillua në Düsseldorf, më 16–17 Nëntor 2025, në kuadër të panairit ndërkombëtar MEDICA/COMPAMED 2025.

Pjesëmarrja në këtë panair krijoi mundësinë të ndërveprojmë drejtpërdrejt me kompani të fushës, të prezantojmë potencialin e Shqipërisë dhe të forcojmë pozicionimin tonë si destinacion i favorshëm për investime në këtë industri në rritje. Gjatë dy ditëve të takimit, u zhvilluan rreth 15 takime.

Gjatë takimeve, u vu re fakti se një numër i konsiderueshëm kompanish tashmë kanë partneritete me kompani që operojnë në Shqipëri, çka paraqet një mundësi reale për të çuar më tej marrëdhëniet ekzistuese dhe për të ndërtuar bazën për investime të reja direkte.

Në të dyja ditët e fushatës, AIDA pati mundësinë të përçojë një mesazh të qartë dhe të strukturuar mbi përparësitë që ofron vendi ynë për investitorët e huaj: stabilitetin makroekonomik, një klimë të favorshme biznesi, kostot konkurruese, akses të shpejtë drejt tregjeve të BE-së dhe rajonit, si dhe përqendrimin në zhvillimin e sektorëve me vlerë të shtuar.

Fushata outreach u përmbyll me sukses, duke konsoliduar kontakte të rëndësishme dhe duke rritur interesin për Shqipërinë si një destinacion konkurrues për investime në sektorin e prodhimit të pajisjeve mjekësore. AIDA nisi një proces të strukturuar folloë-up-i me të gjitha kompanitë e takuara. Gjatë muajit dhjetor u organizuan dy takime online me kompanitë Barkeley Health dhe Moslab.

6. Projekte të vlerësuara nga Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS) përgjatë periudhës raportuese për vitin 2025

Me hyrjen në fuqi të paketës ligjore për investimet strategjike (datë 24.12.2015), u bë e mundur që investimet vendase dhe të huaja, në sektorët më të rëndësishëm të shpallur strategjikë, të lëvizin më me shpejtësi, me procedura të përshpejtuara dhe favorizuese.

Në zbatim të kësaj pakete ligjore, AIDA ka tre funksione të tjera shtesë:

- One Stop Shop për aplikimet për investim/ investitor strategjik
- Sekretariat Teknik i Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS)
- Agjent asistues i investitorit strategjik

Misionet e mësipërme realizoheshin nga Sektori One Stop Shop brenda Drejtorisë së Investimeve, por duke qenë se puna para dhe pas vlerësimit të një projekti investimi është masive, lindi nevoja për krijimin e Drejtorisë së Investimeve Strategjike, e krijuar rishtazi me miratimin e strukturës së re të AIDA, e cila përbëhet nga 2 sektorë:

1. Sektori i One Stop Shop
2. Sektori i Monitorimit

Në këtë aspekt, Drejtoria e Investimeve Strategjike:

- Kryen veprimet përgatitore dhe shërbimet e nevojshme ndaj projektit potencial strategjik dhe investitorit/investitorëve potencialë strategjikë (pra dy statuse të ndryshme), veçanërisht ato të verifikimit të tokës dhe përputhjes së projektit të investimit me planin kombëtar të rregullimit të territorit (proces i cili përfshin një sërë institucionesh njëkohësisht);
- Koordinon procesin vlerësues të një projekti nga Grupi Operacional, me shpejtësi dhe efikasitet (brenda një afati maksimal prej 30 ditësh);
- Përgatit raportet për KIS, në rolin e Sekretariatit Teknik dhe harton një sërë aktesh administrative pas vendimeve të KIS.
- Monitoron zbatimin e planit të veprimit të Vendime të KIS nga ana e subjekteve dhe institucioneve.

Zbatimi i ligjit përgjatë kësaj periudhe ka krijuar një rrjet komunikimi ndërinstitutional shumë funksional. Ligji i investimeve strategjike Nr.55/2015, i ndryshuar, ka shtyrë afatin e aplikimeve deri në 31.12.2026.

Në vitin 2025 rezulton se:

- Kërkesat e ardhura nga subjektet të cilat janë në fazë asistimi pranë AIDA për vitin 2025 janë 27 projekte në total. Aktualisht, subjektet janë takuar në mënyrë periodike nga stafi i AIDA duke u asistuar mbi procedurat e aplikimit dhe dokumentacionin përkatës që duhet të dorëzohet.
- Projekte të aplikuara për përfshirjen në procedura administrative të legjislacionit të investimeve strategjike me qëllim përfitim statusi strategjik, të cilat janë në proces vlerësimi janë 4 projekte në total, nga të cilat 2 janë në proces vlerësimi nga GO dhe 2 projekte janë në fazë pritje përgjigje nga ministria përgjegjëse për ekonominë për caktimin e emrave në GO.
- Numri i projekteve të miratuara me Vendim të Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS) në vitin 2025 janë 7 projekte në total.
- Gjithashtu janë trajtuar 3 vendime në datë 30.12.2025 nga të cilat 2 shtyrje afati dhe 1 mosmiratim. Këto janë në proces zbardhje pandaj nuk janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme.

VITI	2025
Projekte në fazë vlerësimi nga grupi operacional	2
Projekte të miratuara nga KIS	7
Projekte të refuzuara	1
Projekte në fazë asistimi	27
Total	37

- Lidhur me monitorimin e projekteve:

Aktualisht, vazhdon procesi i komunikimeve me subjektet të cilat kërkojnë asistencë lidhur me zbatimin e vendimeve të KIS. Ndërkohë ka filluar puna për ndjekjen e zbatimit të Planit të Veprimit të KIS nga subjektet dhe janë përgatitur shkresat për monitorimit e tyre. Këto shkresa do të drejtohen 13 subjekteve të cilat kanë përfituar statusin investim/investor strategjik.

b) Performanca e produktit “Grante për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme” (shpenzime korente) dhe 2 (dy) projekteve të financimit: “Fondi i Konkurrueshmërisë” dhe “Fondi i Ekonomisë Kreative” (shpenzimeve kapitale).

AIDA për vitin 2025, po menaxhon Fondin “Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme” i cili synon rritjen e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve, zhvillimin e produkteve dhe

shërbimeve, rinovimin e teknologjisë, zhvillimin e artizanatit si dhe mbështetjen e grave sipërmarrëse me qëllim nxitjen drejt eksportit dhe forcimin e aftësive të tyre lidhur me shërbimet dhe produktet për një treg të qëndrueshëm.

Vlera totale e këtij fondi e vënë në dispozicion për NVM-të ka qenë në masën 131,830,000 lekë. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ka publikuar në faqen e saj zyrtare, thirrjen për “Mbështetje për Zhvillim Ekonomik” të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme”, për vitin 2025.

Thirrja për aplikime qëndroi e hapur për 30 ditë kalendarike, nga data 30 Janar 2025 deri me datë 28 Shkurt 2025.

Gjithsej aplikuan 443 subjekte.

Skema 1

◦ ***Fondi i Shpenzimeve Korrente***

Aplikime në total 250 dosje, nga të cilat:

- ✓ 79 dosje me mangësi
- ✓ 171 dosje të plota të vlerësuara nga bordi vlerësimeve
- ✓ 57 dosje fituese, nga të cilat subjekte fituese femra janë 25

Skema 2

◦ ***Fondi Artizanatit (Biznesi Kreativ)***

Aplikime në total 19 dosje, nga të cilat:

- ✓ 6 dosje me mangësi
- ✓ 13 dosje të plota të vlerësuara nga bordi vlerësimeve
- ✓ 10 dosje fituese, nga të cilat subjekte fituese femra janë 7

◦ ***Fondi i Konkurrueshmërisë***

Aplikime në total 174 dosje, nga të cilat:

- ✓ 54 dosje me mangësi
- ✓ 120 dosje të plota të vlerësuara nga bordi vlerësimeve
- ✓ 19 dosje fituese, nga të cilat subjekte fituese femra janë 6

Kemi përfunduar tërësisht disbursimin e fondeve për vitin 2025.

c) Përformanca e projektit “Përmirësim sistemesh”, nga zëri shpenzime kapitale (llogaria 231).

Fondi në dispozicion prej 1,170,000 lekë për projektin “Përmirësim sistemesh”, nuk ka mundur të hidhet në regjistrin për prokurim publik në vitin 2025 pasi ky zë lidhet me mirëmbajtjen e sistemit të Regjistrit të Investimeve Strategjike, i cili nuk u finalizua vitin e kaluar. Ndaj me shkresën tonë nr. 320 prot., datë 17.02.2025 “Kërkesë për ndryshim destinacioni të fondit të akorduar për

projektin me financim të brendshëm 'Përmirësim sistemesh', pjesë e programit ekonomik "Mbështetje për zhvillim ekonomik", kemi kërkuar ndryshim destinacioni të këtij fondi. Konkretisht u kërkuua alokimi i fondit prej 1,170,000 lekë për projektin "Blerje pajisje zyre AIDA". Kjo kërkesë erdhi në kuadër të riskstrukturimit të AIDA-s, proces i cili u shoqërua me shtesë stafi me rreth 12 punonjës të rinj. Kërkesa jonë u miratua nga MEKI (me shkresën me nr. 2772/3 prot., datë 08.04.2025) dhe fondit ju ndryshua destinacioni.

Janë realizuar procedurat e prokurimeve publike në vitin 2025, dhe janë blerë pajisje të mobilerisë, sipas artikujve të kërkuara nga AIDA. Fondi prej 1,170,000 lekë me TVSH i miratuar për vitin 2025 në këtë grup shpenzimesh është realizuar në masën 1,054,800 lekë ose 90%. Pjesa e papërdorur e fondeve ka ardhur si rezultat i përzgjedhjes në procedurë të ofertuesit me çmim/njësi më të ulët.

d) Përformanca e projektit me financim të huaj "Skills for jobs Albania Montenegro", "EEN Albania" dhe projekti "TVSH për projekte me financim të huaj" nga zëri shpenzime kapitale (llogaria 231).

✓ **Projektet me financim të huaj.**

Përsa i përket projekteve me financim të huaj për periudhën raportuese janar – dhjetor 2025, sqarojmë si më poshtë:

- Në lidhje me projektin me financim të huaj me emërtim "Skills for jobs Albania - Montenegro" në buxhetin e AIDA-s për vitin 2025 u parashikua financimi 1,300,000 lekë. Ndërkohë fondet e shpenzuara për këtë projekt për periudhën raportuese janë në masën 372,250 lekë. Projekti në fjalë është mbyllur dhe të gjitha detyrimet e raportimit janë përmbushur. Është proceduar dhe transferimi i vlerës **11,361.76 Euro** duke siguruar mbylljen e rregullt financiare të projektit.
- Në lidhje me projektin me financim të huaj me emërtim "EEN Albania" në buxhetin e AIDA-s për vitin 2025 u parashikuar financimi 4,000,000 lekë. Projekti "Enterprise Europe Netëork – ALBANIA" (EEN-ALBANIA), me numër **101075194**, u zbatua në kuadër të thirrjes SMP-COSME-2021-EEN-01 dhe pati si fokus rritjen e kompanive përmes ofrimit të shërbimeve të integruara të biznesit dhe mbështetjes për inovacion. Projekti financohet nga Bashkimi Evropian nëpërmjet Agjencisë Ekzekutive të Këshillit Evropian të Inovacionit dhe SME-ve (EISMEA), me menaxhim të grantit përmes Portalit të Financimit të BE-së (eGrants). Projekt përfundoi më 30 qershor 2025, me një kohëzgjatje totale prej 42 muajsh, dhe u zbatua në kuadër të një marrëveshjeje konsorciumi. Projekti u mbyll me **83,662.37 Euro** vlerë e realizuar nga të cilat **50,797 Euro** kontribut i EU-se (60%) dhe **32,865.37 (40%)** kontribut i AIDA. Raportimi i periudhës u pranua dhe u miratua nga EISMEA dhe e gjithë shumica kontribut i EU-së është disbursuar pranë llogarise speciale të Bankës Së Shqipërisë.

Fondet e disbursuara nga donatori për kontratën nr.101075194 të konvertuara në monedhën vendase janë në masën 4,952,420.46 lekë.

Gjithashtu, gjatë vitit 2025 AIDA nënshkroi marrëveshjen e grantit për projektin nr.101236267 – EEN Albania me agjencinë ekzekutive EISMEA, që mbështet zbatimin e SMP-së. Kontrata është efektive nga data 1 korrik 2025 deri më 30 qershor 2028, me një vlerë totale prej 360,499.95 euro. Më 23 korrik 2025, në llogarinë e parafinancimit të hapur pranë Bankës së Shqipërisë është transferuar kështu i parë prej 90,124.99 euro. Për AIDA-n (koordinatore e projektit) pjesa takuese është në vlerën 23,973.40 Euro ose 2,325,419.8 lekë ndërsa pjesa tjetër ju transferua partnerëve. Kjo kontratë nuk ishte parashikuar në buxhetin e vitit 2025 pasi nuk dihej nëse AIDA do të shpallej fituese apo jo. Për këtë është kërkuar rishikim i tavanit të buxhetit të miratuar dhe shtim fondesh me rritje tavanit për vitet 2025-2028.

Gjatë periudhës raportuese për mbajtjen e aktiviteteve referuar projekteve janë shpenzuar në total 4,499,586.08 lekë.

✓ TVSH për projekte me financim të huaj

Në zbatim të aktiviteteve në kuadër të implementimit të projektit me financim të huaj “*Skills for jobs Albania Montenegro*”, gjatë periudhës raportuese është kompensuar nga projekti “*TVSH për projekte me financim të huaj*” detyrimi lindur për pagesë fature me vlerë të TVSH-s në masën 16,250 lekë, ndërsa për projektin me financim të huaj “EEN-Albania”, gjatë periudhës raportuese është kompensuar nga projekti “*TVSH për projekte me financim të huaj*”, detyrimi lindur për pagesë fature me vlerë të TVSH-s në masën 325,571 lekë.

Nga plani fillestar i miratuar në për këtë zë prej 4,000,000 lekë, janë bërë pakësime dhe plani i rishikuar në këtë zë për vitin 2025 është 700,000 lekë, realizimi është në masën **341,821 lekë**, pasi aktivitetet referuar projektit me financim të huaj në fjalë nuk kanë gjeneruar fatura me TVSH për të sjellë nevojë për kompensim nga ky fond.

3. Performanca e treguesve kyç të performancës me bazë gjinore, në nivel produkti

Objekti i veprimtarisë të AIDA-s, në buxhetin e akorduar për mbështetje me grante për vitin 2025, konkretisht produkti jo projekt “Grante për mbështetjen e bizneseve” dhe në produktet të ndarë në 2 (dy) projekte, ka parashikuar trajtime me bazë gjinore. Në përfundim të procesit të përzgjedhjes të subjekteve përfituese të granteve, nga analiza e kryer nga Drejtoria e Projekteve, NVM dhe Eksporteve, rezulton se nga 86 përfitues të dy skemave të mbështetjes me grante për vitin 2025, 37 prej tyre kanë drejtuese femër.

Ndërkohë pjesa tjetër e aktiviteteve që zhvillon AIDA në rolin e promovueses të Shqipërisë si destinacion për investime, lidhet me targetimin dhe asistencën që ofrohet për investitorët vendas dhe të huaj, praktikë e cila nuk bën diferencim me bazë gjinore.

4. Përformanca e buxhetit në nivel programi - AIDA

◦ **REALIZIMI I SHPENZIMEVE KORENTE DHE KAPITALE SIPAS TAVANEVE BUXHETORE PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2025**

Në lekë

Artikulli	EMËRTIMI	VLERA NË FILLIM TË VITIT NË BUXHET	VLERAT PAS NDRYSHIMEVE	FAKTI SHPENZIME THESAR JANAR – DHJETOR	REALIZIMI NË (%)
600	Paga	68,363,000	55,045,427	55,045,427	100%
601	Sigurime Shoqërore	9,308,000	9,026,403	9,026,403	100%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	49,502,000	72,502,000	68,380,492	94.3%
604	Grante për mbështetjen e bizneseve	100,000,000	100,000,000	97,493,685	97.5%
606	Transferta për Buxhetet Familjare & Individ	48,000	128,000	40,000	31.3%
A. Total 600-606		227,221,000	236,701,830	229,986,007	97.2%
231	Shpenzime për rritjen e aktiveve qëndrore të trupëzuara (Buxheti Shtetit)	37,000,000	37,000,000	32,726,762	88.4%
231	Shpenzime për rritjen e aktiveve qëndrore të trupëzuara (Financim i huaj)	1,300,000	1,300,000	372,250	28.6%
		4,000,000	4,000,000	4,499,586	112.4%
B. Total 231		42,300,000	42,300,000	37,598,598	89%
TOTAL (A+B)		269,521,000	279,001,830	267,584,605	96%
Kapitulli 6		8,726,815	9,208,315	432,645	5.2%

Gjatë periudhës raportuese, ecuria (performanca) e realizimit të shpenzimeve korente dhe kapitale sipas klasifikimit ekonomik dhe sipas burimeve të financimit, ka patur këtë rezultat:

- **Shpenzime për paga (artikulli 600):** Ky zë është realizuar gjatë periudhës raportuese në masën 100% të fondit të rishikuar për vitin 2025. Aktualisht organika e AIDA-s ka 42 punonjës nga 51 të miratuar.
- **Shpenzime për Sigurime Shoqërore dhe shëndetësore (artikulli 601):** Ky zë është realizuar gjatë periudhës raportuese në masën 100% të fondit të rishikuar për vitin 2025.

- **Shpenzime për mallra dhe Shërbime të Tjera (artikulli 602):** Ky zë është realizuar gjatë periudhës raportuese në masën 94.3% të fondit të rishikuar për vitin 2025. Përpos nevojave dhe prokurimeve përkatëse, në këtë zë janë realizuar shpenzimet për pjesëmarrje në konferenca dhe panaire, realizimin e aktiviteteve dhe të tjera në përputhje me veprimtarinë dhe fokusin e agjencisë.
- **Grante për mbështetje të bizneseve (artikulli 604):** Realizimi i këtij zëri është 97%. Janë realizuar pagesat e të dy kësteve për subjektet fituese. Pjesa e mbetur e fondeve pa përdorur vjen si rezultat i kthimit të shumës nga një prej subjekteve fituese i cili ka kthyer 100% këstin e parë të përfituar.
- **Transferta për Buxhetet Familjare & Individ (artikulli 606):** Ky zë është realizuar gjatë periudhës raportuese në masën 16% të fondit të rishikuar për vitin 2025. Aktualisht nga ky fond janë kryer pagesa që lidhen me kompensimin e shpenzimeve të telefonisë celulare nga Drejtori Ekzekutiv. Theksojmë se gjatë vitit 2025 AIDA masa e miratuar e fondit të veçantë prej 80,000 lekë nuk është realizuar pasi gjatë vitit 2025 nuk ka patur raste për shpërblimin e punonjësve sipas natyrës së përdorimit të këtij grup shpenzimesh, si dalje në pension, sëmundje të rënda që kërkojnë trajtimin të gjatë mjekësor, raste fatkeqësie në familje, etj.

- **Shpenzimet kapitale në artikullin 231:**

I. **Me financim të brendshëm:** Fondet e parashikuara për këtë artikull janë të ndara në:

- *2 (dy) projektet e financimit* për mbështetjen e NMVM-ve për projekte kapitale përkatësisht:
 - Fondi i Konkureshmërisë, buxheti i rishikuar 22,703,333 lekë, realizuar 22,315,474 lekë ose 98.2%
 - Fond i Ekonomisë Kreative, buxheti i rishikuar 9,126,667 lekë, realizuar 9,011,667 lekë ose 98.7%

Fondi i parashikuar për këto projekte është realizuar në masën 98.4%. Gjatë periudhës raportuese është arritur disbursimi i të dy kësteve për të gjithë subjektet e shpallur fitues.

- *Investimin e brendshëm në masën 1,170,000 lekë*, e cila u kanalizua gjatë muajit prill 2025 për zërin “Blerje pajisje zyre AIDA” është realizuar në masën 1,054,800 lekë ose 90 %.
- *Tvsh për projektet me financim të huaj*, buxheti i rishikuar në masën 700,000 lekë është realizuar në masën 341,821 lekë ose 48.8%.
- **Me financim të huaj për projektet:**
 - Me emërtim “Skills for jobs Albania - Montenegro” në buxhetin e AIDA-s për vitin 2025 u detajua plani i thesarit për financim të huaj prej 1,300,000 lekë. Deri në fund të periudhës raportuese realizimi i këtij zëri është në masën 372,250 lekë ose 28.6%.

- Me emërtim “EEN Albania” në buxhetin e AIDA-s për vitin 2025 u detajua plani i thesarit i financimi i huaj prej 4,000,000 lekë. Deri në fund të periudhës raportuese realizimi i këtij zëri është në masën 4,449,586 lekë ose 124.9%.

REALIZIMI I TË ARDHURAVE PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2025

Në zbatim të ligjit nr 55/2015 "Per investimet strategjike ne Republiken e Shqiperise" dhe VKM nr. 1027, date 16.12.2015 "Per tarifat e sherbimeve per investimet strategjike" përfiton të ardhura nga shërbimet e asistencës së kryera pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve për aplikimet për investitor strategjik. Referuar këtyre tarifave, Agjencia për vitin 2025, për shërbimet e kryera ka përfituar dhe derdhur në Buxhetin e Shtetit nga shoqëritë aplikuese për investitor strategjik tarifa në vlerën totale prej **595,005 lekë**.

Gjithashtu AIDA ka përfituar të ardhura jashtë limit për tu përdorur nga **Regional Cooperation Council (RCC)** në bazë të akt marrëveshjes me nr. 1120/3 prot., datë 02.05.2025, në kuadër të *“Fushatë informuese për tërheqjen e investimeve të huaja direkte të qëndrueshme (IHD), duke çuar në rritjen e aktivitetit ekonomik, shkëmbimin e njohurive teknologjike dhe ndikime pozitive rajonale, me qëllimin përfundimtar të krijimit të vendeve të punës dhe përmirësimit të mirëqenies në Ballkanin Perëndimor”*. Gjatë periudhës raportuese është akorduar fondi prej **481,500 lekë**.

Sa më sipër ju sqarojmë se shuma e sipercituar rezulton e përlorur sipas kodeve të institucionit:

- Në kodin e institucionit 1012106, Artikulli 602, Kodi i produktit 91205 AE përdorur 294,644.5 lekë
- Në kodin e institucionit 1004200, Artikulli 602, Kodi i produktit 90409 AG përdorur 138,000 lekë

Në total është shpenzuar 432,644.5 lekë dhe pjesa e mbetur do ti kthehet **Regional Cooperation Council (RCC)**.

5. Performanca jo - financiare e programit buxhetor - AIDA

Nga analiza sasiore e realizimit të objektivit në nivel produkti, për disa tregues AIDA ka arritur nivelet e pritshme.

Më poshtë po ju paraqesim analizën e performancës të produktit jo – projekt *“Promovimi i Shqipërisë si destinacion investimesh dhe shërbimet e kujdesit ndaj klientit”*, në nivel treguesish.

- *Mbështetjen e investimeve të drejtpërdrejta në Republikën e Shqipërisë (IS);*

Gjatë periudhës raportuese realizimi i treguesevë të performancës krahasuar me planin për këtë objektiv janë në një mesatare prej 35%. Ky realizim është në këto norma pasi deri në muajin mars 2025, ligji i ri ‘Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë’, ende nuk kishte hyrë në fuqi, ndaj gjatë kësaj periudhë (Janar - Mars 2025) nuk pati asnjë aplikim për Investitor Strategjik, duke sjellë kështu normë të ulët realizimi të këtyre indikatorëve.

Theksojmë se gjatë kësaj periudhe Drejtoria e Investimeve Strategjike, specifikisht sektori i One Stop Shop ka punuar maksimalisht për ndjekjen e projekteve me status të miratuar dhe atyre në fazë asistimi. Gjithashtu aplikimet e reja janë ndjekur në çdo hap si nga shprehja e interesit deri në fazën përfundimtare të marrjes ose jo të statusit.

- *Suportin e kompanive SME nëpërmjet fondeve;*

Gjatë periudhës raportuese treguesit e performancës për këtë objektiv janë tejkaluar pritshmëritë, me rreth 37 aplikante femra të mbështetura me grante nga 26 që ishte plani dhe 85 aplikant të shpallur fitues nga fondet e vitit 2025, krahasimisht me 65 aplikant që ishte plani.

Objektivat e politikës:		Kodi i Proqramit		Emertimi i programit:	Mbështetje për Zhvillim Ekonomik			
		Objektivat e politikës:		Kodi i Treguesit të Performancës /Produktit	Emertimi i Treguesit të Performancës / Produktit	PLA NI 2025	Fakti për vitin 2025	Drejtori a përgjegjëse
1	Mbështetja e investimeve të drejtpërdrejta në Republikën e Shqipërisë	1.1	Numri i aktiviteteteve promovues	91205AE	Numri i aktiviteteteve promovues	12	12	IHD
		1.2	Nr i kompanive aplikuese për status	91205AE	Nr i kompanive aplikuese	35	9	IS
		1.3	Nr i kompanive përfituese të statusit	91205AE	Nr i kompanive përfituese	20	7	IS

2	Nxitja e Investimeve të Huaja direkte (IHD)	2.1	Numri i takimeve after care te organizuar a	91205AE	Numri i aktiviteteve te organizuara	100	112	IHD
		2.2	Zgjerimi i rrjetit dhe bashkepunimi me partnere	91205AE	Zgjerimi i rrjetit dhe bashkepunimi me partnere	10	10	IHD
		2.3	Numri i kompanive dhe investitoreve te targetuar gjate fushata outreach	91205AE	Numri i kompanive dhe investitoreve te targetuar gjate fushata outreach	50	72	IHD
3	Suportin e kompanive SME nëpërmjet fondeve	3.1	Numri i NVMV-ve te mbeshtetur a me fonde publike	91205AB	Numer perfituesish	65	85	SME
		3.2	Numri i NVMV me drejtuese femer qe ka perfituar nga fondet publike	91205AB	Numer perfituesish	26	38	
		3.3	Numri i kompanive te asistuarane Panaire brenda dhe jashte vendit	91205AE	Numer perfituesish	50	33	

4	Suporti i kompanive NVM (Projekti EEN ALBANIA 2022-2025)	4.1	Ofrimi i shërbimeve e kundrejt NVM-ve	91205AB	Numer	70	268	Sektori projektit SME
		4.2	Klientet (NVM) unike në shërbime të specializuara	91205AB	Numer	7	243	
		4.3	Krijimi i partneriteteve nga NVM-t	91205AB	Numer	7	24	
5	Suporti i kompanive NVM (Projekti EEN ALBANIA 2025-2028/ 5 muaj)	5.1	Ofrimi i shërbimeve e kundrejt NVM-ve	91205AB	Numer	210	46	Sektori projektit SME
		5.2	Klientet (NVM) unike në shërbime të specializuara	91205AB	Numer	21	16	
		5.3	Krijimi i partneriteteve nga NVM-t	91205AB	Numer	13	6	

- *Nxitjen e Investimeve të Huaja direkte (IHD)*

Gjatë periudhës raportuese Janar - Dhjetor 2025, referuar dhe indikatorëve tregues të zbatimit të këtyre objektivave, AIDA ka arritur një realizim të kënaqshëm të këtyre indikatorëve. Gjatë kësaj periudhe është kryer targetimi i investitorëve të mundshëm si dhe takimet e fushatës outreach që u mbajtën në muajin qershor 2025. Mesatarja e realizimit të këtyre treguesve për periudhën Janar – Dhjetor 2025 është në një normë prej 100%.

6. Përfundime dhe konkluzione

Në përfundim, AIDA gjatë periudhës raportuese për vitin 2025 ka arritur të kënaqshme të realizimit të objektivave, me fokus si më poshtë:

Rruga "Skënderbeut Shkollor", Nd.1, H.G, Tiranë
 Tel: +355 (0) 2251001, <http://www.aida.gov.al>, e-mail: info@aida.gov.al

- Nxitjen e investimeve të huaja dhe vendase nëpërmjet organizimit të Eventeve promovuese si ‘Match Maker Albania 2025’ dhe ‘Zan’Art’. Gjithashtu edhe nëpërmjet realizimit të fushatës outreach në sektorin ICT/BPO.
- Nxitjen e ndërkombëtarizimit (eksportin e produkteve nga prodhuesit vendas) dhe tërheqjen e investimeve të huaja nëpërmjet pjesëmarrjes në 6 (gjashtë) panairë ndërkombëtare me standë.
- Pas rishikimit të buxhetit për ndryshim destinacioni të fondit, konkretisht u kërkua alokimi i fondit prej 1,170,000 lekë, nga “Përmirësim sistemesh”, në “Blerje pajisje zyre AIDA”. Është realiuar procedura e prokurimit të fondit prej 1,170,000 lekë me TVSH sipas sasive dhe specifikimeve të kërkuara nga AIDA.
- Mbështetjen e NMVM-ve me fonde, nëpërmjet finalizimit të procesit të subjekteve fituese të të dy skemave të granteve për vitin 2025 konkretisht, skema 1 për projektet me shpenzime korente dhe skema 2 për projektet me shpenzime kapitale. Për të dyja skemat ka përfunduar disbursimi i kësteve.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR EKZEKUTIV

LAURA PLAKU (SARO)

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

DREJTOR NË DREJTORINË E INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VALBONA LEGISI



Rruga “Skerdilajd Llagami”, Nd.1, H.6, Tiranë

Tel: +355 (0)42251001, <http://www.aida.gov.al>, e-mail: info@aida.gov.al

[illegible]

Kodi i Ministrisë/Institucionit	Kodi i Kapitullit	Emërtimi i Kapitullit	Periudha e raportuese	Vjetore	Buxheti	Shpenzime kapitule të parashtruara	Shpenzime kapitule të trupëzuara	Pagat	Kontingjent dhe shpenzime shqiptare	Mallë dhe shërbime	Subvencione	Të tjera transferuese	Transferues të korrentit dhe transferues të huaj	Buxheti familjor dhe individ	Total
						230	231	600	601	602	603	604	605	606	Total
04	01	Nga Buxheti	2025		Plani fillestar	6,831,032	18,379,012	18,379,012	1,111,519	20,047,951	0	22,554,083	100,000	69,023,597	
04	01	Nga Buxheti	2025		Plani i rishikuar	6,831,032	18,379,012	18,379,012	1,111,519	20,047,951	0	22,554,083	100,000	55,424,427	
04	01	Nga Buxheti	2025		Fakti	6,212,973	5,061,439	829,922	15,942,007	20,047,951	0	22,554,083	100,000	48,678,692	
04	01	Nga Buxheti	2025		Angazhime						0				
04	02	Financim i huaj - Grant	2025		Plani fillestar	2,004,297	2,004,297	2,004,297	0	2,004,297	0	2,004,297	0	2,004,297	
04	02	Financim i huaj - Grant	2025		Plani i rishikuar	2,004,297	2,004,297	2,004,297	0	2,004,297	0	2,004,297	0	2,004,297	
04	02	Financim i huaj - Grant	2025		Fakti	2,503,883	2,503,883	2,503,883	0	2,503,883	0	2,503,883	0	2,503,883	
04	02	Financim i huaj - Grant	2025		Angazhime				0		0				
04	04	TVSH, Detyrim Doganor	2025		Plani fillestar	1,695,725	1,695,725	1,695,725	0	1,695,725	0	1,695,725	0	1,695,725	
04	04	TVSH, Detyrim Doganor	2025		Plani i rishikuar	395,725	395,725	395,725	0	395,725	0	395,725	0	395,725	
04	04	TVSH, Detyrim Doganor	2025		Fakti	37,546	37,546	37,546	0	37,546	0	37,546	0	37,546	
04	04	TVSH, Detyrim Doganor	2025		Angazhime				0		0				
04	05	Nga të ardhurat e veta	2025		Plani fillestar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
04	05	Nga të ardhurat e veta	2025		Plani i rishikuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
04	05	Nga të ardhurat e veta	2025		Fakti	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
04	05	Nga të ardhurat e veta	2025		Angazhime				0		0				
04		Total	2025		Plani fillestar	10,531,054	18,379,012	18,379,012	1,111,519	20,047,951	0	22,554,083	100,000	72,723,619	
04		Total	2025		Plani i rishikuar	9,231,054	5,061,439	829,922	20,047,951	20,047,951	0	22,554,083	100,000	57,824,449	
04		Total	2025		Fakti	8,754,402	5,061,439	829,922	15,942,007	20,047,951	0	20,620,351	12,000	51,220,121	
04		Total	2025		Angazhime						0				
04		Ndryshimi në vlerë absolute	2025								0				
04		Realizimi në %	2025								80	91			
04			2025								0				
04			2025								0				
04	06	Nga të ardhurat jashtë limitit	2025		Fakti	0	0	0	0	138,000	0	0	0	138,000	
04	06	Nga të ardhurat jashtë limitit	2025		Angazhime						0				

Emri	Firma	Data	Sektorial i Përgjithshëm	Firma	Data

Artikujt buxhetore

Aneksi 1.2 "Shpenzimet Buxhetore në Total Programi dhe Total Ministrisë/Institucioni Buxhetor" (AIDA)

Periudhe e Raportimit: 12-2025 GRUPI C4

Kodit Ministria	Programi	Entiteti i Programit	Viti	Titulli Buxhetit	Art. 230	Art. 231	Art. 600	Art. 601	Art. 602	Art. 603	Art. 604	Art. 605	Art. 606	Total
04	04.130	Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	2025	Plani fillestar	0	10,531,054	18,379,012	1,111,519	20,047,951		22,554,083		100,000	72,723,619
04	04.130	Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	2025	Plani i rishikuar	0	9,231,054	5,061,439	829,922	20,047,951		22,554,083		100,000	57,824,449
04	04.130	Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	2025	Shpenzime faktike	0	8,754,402	5,061,439	829,922	15,942,007		20,620,351		12,000	51,220,121
04	04.130	Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	2025	Angazhime	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
04		Mbështetje për Zhvillim Ekonomik	2025	Mbështetje në vlerë absolute	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
04		Realizimi në %	2025		0	95	100	100	80			0	12	89

Emri	Emri	Emri	Emri
Emri i Programit	Emri i Programit	Emri i Programit	Emri i Programit
Data	Data	Data	Data

Exigües i Emissiòn d'Instruments de Programari	Data	S'elesta el període d'informe	Data
	Forma		Forma
	Emisi		Emisi

[illegible]

[illegible]

Dreijahres- / Exklusiv-Markenschutzprogramm			<table><tr><td>Datum</td><td></td></tr><tr><td>Firma</td><td></td></tr><tr><td>E-Mail</td><td></td></tr></table>			Datum		Firma		E-Mail			
Datum													
Firma													
E-Mail													
<table><tr><td colspan="2">Sekretariat / Pergolienheim</td></tr></table>			Sekretariat / Pergolienheim		<table><tr><td>Datum</td><td></td></tr><tr><td>Firma</td><td></td></tr><tr><td>E-Mail</td><td></td></tr></table>			Datum		Firma		E-Mail	
Sekretariat / Pergolienheim													
Datum													
Firma													
E-Mail													

Aneksi 1.2 "Shpenzimet Buxhetore në Total Programi dhe Total Ministrife/Institucioni Buxhetor" (AIDA)

Periodha e Raportimit: 12-2025 GRUPI 12

Kodi i Ministrise/Programit	Emertimi i Programit	Viti	Tipi i Buxhetit	Art. 230	Art. 231	Art. 600	Art. 601	Art. 602	Art. 603	Art. 604	Art. 605	Art. 606	Total
12	Mbeshetje për Zhvillim Ekonomik	2025	Plani fillestar	0	42,300,000	68,363,000	9,308,000	49,502,000	0	100,000,000	0	48,000	269,521,000
12	Mbeshetje për Zhvillim Ekonomik	2025	Plani i rishikuar	0	29,768,946	49,983,988	8,196,481	52,454,049	0	77,445,917	0	28,000	217,877,381
12	Mbeshetje për Zhvillim Ekonomik	2025	Shpenzime faktike	0	28,641,196	49,983,988	8,196,481	52,438,485	0	76,873,334	0	28,000	216,361,484
12	Mbeshetje për Zhvillim Ekonomik	2025	Angazhime	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
12	Mbeshetje për Zhvillim Ekonomik	2025	Ndrryshimi re vliere absolute	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
12	Realizimi re %	2025		0	97%	100%	100%	100%		99%		100%	99%

Emri	Emri i Sektorit i Përfshirjes	Data
Forma	Forma	
Data		

[illegible]

Dreijerei / Leihfirma Menachares Le Program	Date	Firma
Kont.		
Sekretariat	Pegibisitem	Data
		Firma
		Kont.

explore

OK

